# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-457475**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Imzot Dodë Gjergji reagon për vendimin ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së: Kombi duhet të jetë i bashkuar |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/imzot-dode-gjergji-reagon-per-vendimin-ndaj-ish-drejtuesve-te-uck-se-kombi-duhet-te-jete-i-bashkuar/1018563/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 11:00:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 10:58:19 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `86c15afae74ce57cd9e5c2de611a92251b544a82e3dae100753de6d9a8cc6a73` |
| TEKSTI | `aa8f1d501f82e45c2f07196729735f40b4d0e9222624407998147e65adfca1a4` |
| PAMJA | `ebb997012d2fba79a6326948c91f3a2ca4f9aa014e50d880d5e4795b80310cb3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `06ba8c195ed1afc64181355c7c3f62158cdd69111b4cba02ca44587fbca797e1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a0b332b3aa7ecfa1fb91f9dd35095ec558c07d306f6207fe4bc42429a4dfb028` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/06ba8c195ed1afc64181355c7c3f62158cdd69111b4cba02ca44587fbca797e1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Imzot Dodë Gjergji reagon për vendimin ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së: Kombi duhet të jetë i bashkuar




Pas vendimit të marrë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, ka reaguar përmes një deklarate me shkrim drejtuar mediave.

Sipas tij, vendimi ka sjellë hidhërim të thellë, duke rikthyer njëkohësisht ndjesinë e padrejtësive historike.

Gjergji deklaroi se vendimi i Dhomave të Specializuara dëshmon edhe një herë se "kalvari" i padrejtësive historike nuk ka përfunduar. Ai theksoi se në këto rrethana mbetet domosdoshmëri bashkimi për ta bindur drejtësinë që të tregohet e drejtë ndaj shqiptarëve.

Ipeshkvi kërkoi që dhimbja të mos mbizotërojë mbi arsyen dhe që zemërimi të mos e dobësojë urtinë.

Ai vlerësoi se reagimet duhet të karakterizohen nga maturia, paqja dhe përgjegjësia, ndërsa kundërshtimi i vendimit duhet të ndiqet nëpërmjet mekanizmave juridikë dhe institucionalë.

Sipas Gjergjit, zemërimi i një populli mund të kuptohet vetëm kur ai kthehet në energji për kërkimin e së vërtetës dhe të drejtësisë.

Institucioneve dhe klasës politike të Kosovës, ai u kërkoi të veprojnë me përgjegjësi dhe në mënyrë të bashkërenduar.

Gjergji nënvizoi se dallimet duhet të kapërcehen sa herë që cenohen liria, dinjiteti dhe kujtesa historike e popullit.

Ai bëri thirrje për bashkim kombëtar rreth së vërtetës, dinjitetit dhe përgjegjësisë për të ardhmen. Sipas tij, kështu mund të mbrohet pastërtia e përpjekjes së popullit për liri, të fuqizohen miqësitë me ata që qëndruan pranë në ditët më të vështira dhe të rikthehet besimi i dëmtuar pas çlirimit.

të fundit/


Arrestohet 20-vjeçari në Shkup, iu sekuestrua marihuanë në banesë


Dorëhiqet kreu i Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastër pas…


Influencuesja 21-vjeçare ekzekutohet në sy të të atit, pak ditë…


FOTO/ Angelina Jolie rrëmben vëmendjen, veshja i nxjerr në pah…


Mungoi në listën e Kombëtares, Jasir Asani reagon me iron…


Altin Krasniqi: Dënimi me 25 vjet është shumë i rëndë, babai mund t…


Berisha kërkon seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit pas vendimi…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Ipeshkvi theksoi gjithashtu nevojën që Kosova të vazhdojë t'i ruajë raportet miqësore me shtetet që e mbështetën gjatë luftës, si dhe të punojë për rindërtimin e besimit të lënduar pas çlirimit.

Duke folur për rolin e Kishës, Gjergji tha se ajo nuk mund të marrë përsipër gjykimin e njerëzve apo të drejtësisë, por njëkohësisht nuk mund të qëndrojë e heshtur përballë kësaj situate.

Ai u shpreh se detyrë e përbashkët është kërkimi i së vërtetës pa urrejtje, i drejtësisë pa hakmarrje dhe i pajtimit pa harruar atë që është e drejtë.

Në përfundim, Gjergji deklaroi se Kosovës nuk i nevojitet më shumë zhurmë, por urtësi, unitet, qëndrueshmëri dhe besim.

Më 16 shtator, Gjykata Speciale në Hagë dënoi në shkallën e parë ish-presidentin Hashim Thaçi me 25 vjet, Jakup Krasniqin me 25 vjet, Kadri Veselin me 18 vjet dhe Rexhep Selimin me 13 vjet.

Shtuar më 19.09.2026 12:58

Tags: Imzot Dodë Gjergji , Ipeshkvi , uck



Altin Krasniqi: Dënimi me 25 vjet është shumë i rëndë, babai mund të mo…



Berisha kërkon seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit pas vendimit të…



Jashari kërkon anëtarësimin e Kosovës me të drejta të plota në Kartë…



FSK-ja zhvillon ushtrimin "Valor Shield 2026" me ushtritë e SHBA-së,…



Përpjekja për grusht shteti do të dështojë", Naim Miftari reagon ndaj sulme…



Berishaj pas aktgjykimit në Hagë: Kosova s'do të lejojë përdorimin e verdiktit…



Kërcënoi ministren Donika Gërvalla, një person përfundon në paraburgim



Me përfundimin e proceseve në Hagë, kujt do t'i mbetet drejtësia për…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko…  Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.